



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 711/1 Prot.

Tiranë, më 14 . 04 . 2026

### V E N D I M

**Nr. 82, Datë 14 . 04 . 2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 243, datë 21.10.2025, e bërë nga z. E.Ç kundër Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve (Startup Albania), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “vendbanimit”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam një sipërmarrës nga qyteti i Vlorës dhe kam aplikuar në programin kombëtar për mbështetjen e startup-eve, i menaxhuar nga Agjencia “Startup Albania”.

*Nga analiza e rezultateve të publikuara për këtë program, si dhe nga publikime të mëparshme, rezulton se pjesa dërrmuese e përfituesve, rreth 85-90%, dhe në vlerë absolute e granteve, kjo përqindje është edhe më e lartë dhe kanë vendndodhje në Tiranë. Ndërkohë, qytetet e tjera të Shqipërisë janë përfaqësuar shumë pak ose aspak.*

*Në kriteret e thirrjes nuk parashikohet asnjë masë për barazi rajonale, ose për të garantuar që fondet publike të ndaheshin në mënyrë të drejtë në të gjithë territorin e vendit. Një politikë që në dukje është neutrale, në praktikë ka krijuar një avantazh sistematik për aplikantët nga Tirana, ku*

*zhvillohen më herët prezantimet e thirrjeve, workshop-et informuese dhe ku ndodhen shumica e strukturave mbështetëse të ekosistemit të startup-eve.*

*Kjo qasje e parregullt dhe diskriminuese jo vetëm që nuk mbështet zhvillimin e startup-eve, por në fakt penalizon ato që veprojnë në rrethe. Startup-et e këtyre zonave detyrohen të përballen dhe të konkurrojnë me subjekte që gëzojnë akses në tregje më të gjera e më dinamike, si dhe në burime financiare dhe grante më të shumta. Ky avantazh i padrejtë pozicionon startup-et e kryeqytetit në një situatë privilegjuese, duke i bërë ato praktikisht të pakonkurueshme ndaj startup-eve të rretheve.*

*Kjo, sipas mendimit tim, përbën diskriminim të tërthortë mbi bazë vendbanimi/gjeografie, pasi ndikon në mënyrë të vazhdueshme dhe negative ndaj një grupi personash, konkretisht, sipërmarrësve që nuk ndodhen në kryeqytet, duke i përjashtuar nga mundësia reale për të përfitur nga një skemë publike që duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe e drejtë për të gjithë qytetarët”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe dhënien e masave rekomanduese për garantimin e barazisë gjeografike në përfitimin e fondeve publike në thirrjet e ardhshme.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1478/1, datë 10.11.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Agjencia Startup Albania, lidhur me pretendimet e ankuesit, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
  - Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
  - Kopje të kalendarit të prezantimit të thirrjeve, workshop-eve dhe sesionet konsultuese, për thirrjet për Grantin e vitit 2025. Këtu të përfshihen qytetet se ku janë zhvilluar këto aktivitete dhe numrin e pjesëmarrësve.
  - Informacion sa është numri i aplikuesve gjithsej dhe të ndarë, sa janë nga Tirana dhe sa janë nga qytetet e tjera, për thirrjet e grantit të vitit 2024 dhe përfituesit e këtij granti, të ndarë, sa janë nga Tirana dhe sa janë nga qytetet e tjera.
  - Informacion sa është numri i aplikuesve gjithsej dhe të ndarë, sa janë nga Tirana dhe sa janë nga qytetet e tjera, për thirrjet e grantit të vitit 2025 dhe përfituesit e këtij granti, të ndarë, sa janë nga Tirana dhe sa janë nga qytetet e tjera.
  - Informacion, nëse është pasur parasysh shpërndarja gjeografike e fituesve duke qenë se ankuesi pretendon se: *“Startup-et e këtyre zonave detyrohen të përballen dhe të konkurrojnë me subjekte që gëzojnë akses në tregje më të gjera e më dinamike, si dhe në burime financiare dhe grante më të shumta. Ky avantazh i padrejtë pozicionon startup-et e kryeqytetit në një situatë privilegjuese, duke i bërë ato praktikisht të pakonkurueshme ndaj startup-eve të rretheve”*.
  - Kopje të plotë të ankesave të bëra nga z. E.Ç dhe përgjigjeve të dhëna nga institucioni.
  - Kopje të Rregullores së Thirrjes për Grant 2025, ose link-un e kësaj rregulloreje.

Me shkresën nr. 502/1, datë 19.11.2025, Agjencia Startup Albania, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Startup Albania është një agjenci shtetërore, krijuar dhe që funksionon bazuar në nenin 9/1, të Ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, të ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 467, datë 26.07.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve”*.

*Pjesë e përgjegjësive funksionale të Startup Albania, është ndër të tjera edhe menaxhimi dhe monitorimi i realizimit të masave mbështetëse financiare nëpërmjet fondeve publike ose të të tretëve për nismat në ekosistemin e startup-eve (shkronja a), pika II e VKM-së).*

*Që prej krijimit të saj Agjencia operon mbi bazën e parimit të transparencës dhe aksesit të barabartë të të gjithë qytetarëve dhe aktorëve të ekosistemit pa asnjë dallim.*

*Në funksion të sa më sipër, Agjencia publikon çdo njoftim, udhëzim, rregullore apo thirrje për aplikime në:*

- faqen zyrtare të internetit [www.startupalbania.gov.al](http://www.startupalbania.gov.al);
- rrjetet sociale zyrtare të Startup Albania dhe të Ministrisë përgjegjëse për inovacionin;
- median kombëtare, përmes daljeve publike (intervista, artikuj) dhe njoftimeve të dedikuara apo sesioneve me prezencë fizike ose online me individë/persona juridik të interesuar për të përfituar nga thirrjet për grante.

Gjithashtu, çdo kërkesë për informacion trajtohet dhe i jepet përgjigje brenda afateve ligjore, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, përmes adresës zyrtare [info@startupalbania.gov.al](mailto:info@startupalbania.gov.al), ose në formë shkresore.

Gjatë viteve 2024 dhe 2025, në kuadër të thirrjeve që janë linçuar, janë zhvilluar fushata informuese me shtrirje gjeografike dhe territoriale, përkatësisht në qarkun Shkodër, Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Korçë. Këto evente janë realizuar edhe në bashkëpunim me Universitetet dhe Bashkitë përkatëse në qark. Ato janë realizuar me qëllim garantimin e aksesit dhe informacionit të barabartë për të gjithë qytetarët dhe aktorët e ekosistemit të inovacionit në nivel kombëtar.

Për sa i takon procedurës së përzgjedhjes, duke përfshirë kriteret përkatëse sjellim në vëmendje si më poshtë:

Neni 14 i ligjit të lartpërmendur parashikon se startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve të vetëdeklaruar në regjistër mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.

Procedura dhe kriteret janë të parashikuara në VKM nr. 61, datë 07.02.2024 “Për miratimin e kërkesave e të kriterëve që duhet të plotësojnë Startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kriterëve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblimit të anëtarëve të tyre”. Kriteret e vendosura janë objektive dhe të matshme dhe lidhen ngushtësisht me cilësinë (meritën) e aplikimit. Përkatësia gjeografike e aplikantëve nuk përbën kriter përzgjedhës sipas akteve të lartpërmendura.

Vlerësimi i aplikimeve kryhet nga një Komision i ngritur bazuar në parashikimet e Kreut IV “Ngritja e komisionit të vlerësimit dhe ankimit” dhe nuk është vendimmarrje monokratike.

Komisioni që ngrihet me Urdhër të ministrit përgjegjës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i startup-eve. Kriteret për anëtarët e Komisionit janë gjithashtu të parashikuara në këtë Vendim. Ata përzgjidhen bazuar në një proces transparent, bazuar në thirrjen e hapur, të publikuar në faqen zyrtare të Startup Albania dhe ministrit përgjegjës. Në kontekstin e përzgjedhjes, Startup Albania vepron si sekretariat teknik dhe nuk ka asnjë kompetencë vlerësimi. Drejtori i Agjencisë është anëtar exofficio i Komisionit, por ai/ajo është vetëm 1 prej 5 anëtarëve të tij.

Bazuar në sa më sipër, është miratuar edhe Rregullorja e Thirrjes, Grant 2025 që përmban edhe pikëzimin e aplikimeve sipas kriterëve përkatëse. Më shumë të dhëna gjeni në linkun e mëposhtëm:

<https://www.sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Rregullore-e-Thirrjes-Grant-2025.pdf>

Gjithashtu VKM-ja e lartpërmendur parashikon edhe procedurë ankimi për kërkuesit për shkelje të procedurës së shqyrtimit të kërkesës. Përgjigjja e ankimit i është njoftuar subjektit nëpërmjet adresës elektronike zyrtare.

Procedura e vlerësimit përfshin dy hapa:

- Kontrolli administrativ dhe i përshtatshmërisë së të gjitha aplikimeve të pranuar;
- Përzgjedhja e aplikimeve (bazuar në shqyrtimin nga komisioni i vlerësimit dhe ankimit).

Për sa më sipër, vlerësimi i aplikimeve kryhet mbi bazë ligjore të qartë, mbi kriterë objektive që lidhen me meritën (cilësinë) e aplikimit përmes një sistemi pikëzimi që garanton objektivitet, gjurmueshmëri dhe matshmëri të çdo elementi të analizuar. Komisioni i vlerësimit, vlerëson përmbushjen apo jo të kriterëve ligjore të përcaktuara, duke siguruar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. Ky është vlerësim kolegjal dhe i standardizuar me synimin për të eliminuar çdo mundësi favorizimi apo diskriminimi, duke garantuar që rezultatet të pasqyrojnë ekskluzivisht meritat (cilësinë) e aplikimit dhe kapacitetet/burimet e aplikantit.

As ligji dhe as vlerësimi i Komisionit nuk përfshin një kriter vlerësimi që lidhet me vendbanimin, si shkak ligjor të refuzimit të aplikimit. Prandaj shkak për të cilin aplikanti është trajtuar në mënyrë përjashtuese (dhe jo përfituese të grantit) nga ana e Komisionit, nuk është vendbanimi i tij, por cilësia e aplikimit. Z. E.Ç ka marrë 129.2 pikë nga 350 pikë në total.

Në këtë rast, nuk jemi përpara një trajtimi të padrejtë e në shkelje sipas ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Më poshtë janë të dhënat statistikore për aplikimet dhe fituesit për vitet 2024 dhe 2025:

Viti	Numri i aplikimeve	Aplikime Tirana	Aplikime Vlora	Aplikime Durrës	Numri i fituesve	Fitues Tirana	Fitues Vlora	Fitues Durrës
2024	538	351	20	35	89	79	1	2
2025	422	270	19	29	81	67	3	3

Këto të dhëna pasqyrojnë ekzistencën e një raporti proporcional të shtrirjes territoriale midis numrit të aplikimeve të marra dhe atyre të shpallura fituese. Të dhënat statistikore konfirmojnë qasjen gjithëpërfshirëse dhe të drejtë të përfitimit të granteve.

*Për sa më sipër vlerësojmë se procedurat e kryera për dhënien e granteve për vitet 2024, 2025 (që nga momenti i shpalljes me fushatën ndërgjegjësuere e deri në shpalljen e fituesve) janë zhvilluar në përputhje me parimin e meritokracisë, transparencës, bazuar në thirrje të hapur, duke i garantuar akses kujtdo që ka qenë i interesuar. Pretendimet e ngritura në lidhje me diskriminim nuk gjejnë mbështetje ligjore ose faktike dhe për rrjedhojë nuk jemi përpara rastit të diskriminimit për shkak të përkatësisë apo vendndodhjes në një territor të caktuar të vendit”.*

- Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 02.12.2025, është njohur me përgjigjen e Agjencisë Startup Albania.

Në kundërshtim të përgjigjes të Agjencisë Startup Albania, ankuesi me email-in datë 02.12.2025, në mes të tjerash ka informuar se: *“Që në fillim të përgjigjes, Agjencia deklaroi se operon mbi parimin e transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë qytetarët dhe aktorët e ekosistemit, pa dallim vendbanimi, gjinie, moshe apo karakteristikash të tjera.*

*Megjithatë, vetë thirrja e Startup Albania thotë qartë se ekziston një bonus prej 5% për aplikantët gra/vajza, sipas nenit 14/3-ç të Ligjit nr. 25/2022. Pra, ekziston një favorizim gjinor, të cilin personalisht e konsideroj të drejtë, por që Startup Albania e mohon në përgjigjen e tyre zyrtare.*

*Startup Albania gjithashtu shmang specifikimin e datave të prezantimit të thirrjes - jo pa qëllim, por sepse shumë prezantime, si ai në Vlorë, janë bërë vetëm pak ditë para mbylljes së thirrjes, gjë që e bën të pamundur një pjesëmarrje cilësore nga aplikantët e zonës.*

*Sa i përket transparencës mbi përzgjedhjen e komisionit, në dijeninë time emrat nuk janë bërë asnjëherë publikë pas shpalljes së fituesve. Dhe për ta përkeqësuar situatën, në përgjigjen e Startup Albania thuhet se Agjencia vepron vetëm si sekretariat teknik dhe nuk ka kompetenca vlerësimi, ndërkohë që drejtori i Agjencisë përbën 20% të komisionit të vlerësimit. Pra, nuk është aspak i paanshëm, siç pretendohet.*

*Mungesa e transparencës vazhdon edhe tek përzgjedhja e fituesve: nuk është bërë asnjëherë e mundur të shihet procesverbali i komisionit, në mënyrë që aplikantët të kuptojnë gabimet ose të përmirësojnë performancën për thirrjet e ardhshme. Në përgjigjen e Startup Albania shfaqet gjithashtu një mospërputhje tjetër: thirrja parashikon vlerësim me 70 pikë, ndërsa në përgjigjen drejtuar jush thuhet se vlerësimi është bërë me 350 pikë. Do të ishte me interes të kuptonim pse Startup Albania nuk ka përdorur sistemin e vlerësimit të përcaktuar në rregullore.*

*Por elementi më i rëndësishëm është pretendimi i Startup Albania se nuk ka diskriminim rajonal. Startup Albania pretendon se ekziston proporcionalitet territorial midis aplikimeve dhe fituesve. Megjithatë, përllogaritjet tregojnë të kundërtën:*

#### ***Tabela e Suksesit për Thirrjet 2024 & 2025***

<i>Viti</i>	<i>Kategoria</i>	<i>Aplikues</i>	<i>Fitues</i>	<i>Norma e suksesit</i>
-------------	------------------	-----------------	---------------	-------------------------

2024	Tirana	351	79	22.51 %
2024	Qytetet e tjera	187	10	5.35 %
2025	Tirana	270	67	24.81 %
2025	Qytetet e tjera	152	14	9.21 %

- Në 2024, një aplikant nga Tirana ka 4.2 herë më shumë shanse për të fituar se një aplikant nga rrethet.
- Në 2025, një aplikant nga Tirana ka 2.7 herë më shumë shanse se një aplikant nga rrethet.
- Diferenca është strukturore dhe e qëndrueshme në të dy vitet.

*Siç tregojnë qartë të dhënat, deklarata e Startup Albania se ekziston një raport proporcional i shtrirjes në territor është e pavërtetë.*

*Jam i bindur se, nëse ky krahasim do të bëhej edhe për vlerën monetare të granteve të përfituara nga Tirana dhe rrethet, situata do të rezultonte edhe më e pabarabartë, pasi grantet nuk kanë të gjitha të njëjtën vlerë.*

*Vlen të përmendet gjithashtu se gjatë prezantimit të thirrjes së fundit 2025 në qytetin e Vlorës pata mundësi të shpreh pakënaqësinë time për shpërndarjen e fondeve në rang vendi për vitin 2024 dhe se është e vërtetë se në prezantim ishin të pranishëm Kryetari i bashkisë dhe Rektorja e universitetit. Kur u publikuan në Facebook të dhënat për Tiranën dhe Vlorën, u duk sikur kishte përmirësim, por ato ishin të pavërteta.*

*Në postimin në Facebook, thuhet se Vlora në vitin 2025 ka pasur +3 fitues, pra 4 në total. Kjo është e pavërtetë, pasi në tabelën e dërguar në përgjigjen zyrtare, fituesit në Vlorë janë vetëm 3.*

*Po ashtu, në postim Startup Albania thotë se Tirana ka pasur -17 fitues krahasuar me 2024, por tabela zyrtare tregon se ndryshimi është -9”.*

Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 87, datë 12.01.2026 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 20.01.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces dhe kërkohet kopje të dokumentacionit, si më poshtë:

- Kopje të kalendarit të prezantimit të thirrjeve, workshop-eve dhe sesionet konsultuese, për thirrjet për Grantin e vitit 2025. Këtu të përfshihen qytetet se ku janë zhvilluar këto aktivitete dhe numrin e pjesëmarrësve.

Seanca u zhvillua në datën e caktuar, me praninë e palëve: subjektit ankues z. E.Ç dhe përfaqësuesve të Agjencisë Startup Albania, z. A.Y dhe O.K.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Personalisht kam pasur mundësinë të jem vetëm dy herë në eventet e organizuara nga Startup Albania: një herë tek Piramida, ku, duke qenë se unë vij nga Vlora, më u desh të shpenzoja 100 mijë lekë të vjetra dhe një ditë pune, dhe aty e pashë që nuk ishte e qëndrueshme për xhepin tim që të bëhesha pjesë e këtyre eventeve; dhe një herë në Vlorë, ku Startup Albania bënte prezantimin e thirrjes pak ditë para se të mbyllej thirrja.*

*Gjithsesi, të dyja herët i shfaqta shqetësimin tim z. Ymeraj për fondet që shkonin thujse vetëm në Tiranë: për vitin 2024, respektivisht 23 milion lekë të reja në rrethe dhe 277 milion në Tiranë.*

*Startup Albania, dhe dua ta përsëris dy herë fjalën Albania, ka një mandat të qartë nga qeveria shqiptare, që është ai i krijimit të një ekosistemi kombëtar të startup-eve, duke ndihmuar edhe financiarisht startup-et e meritueshme, në mënyrë që ky ekosistem të zhvillohet. Shumat e granteve fillojnë nga 1.5 milion lekë të reja deri në 9 milion lekë të reja.*

*Granti tek i cili unë kisha marrë pjesë ishte ai më i vogli, 1.5 milion lekë të reja. Dhe fondi total, si çdo vit, ishte 300 milion lekë të reja. Për vitin 2025, të gjitha rrethet se bashku morën 46 milion lekë të reja, Tirana 254 milion. Para të taksapaguesve të gjithë Shqipërisë që, me anë të Startup Albania-s, kthehen ekskluzivisht vetëm në Tiranë.*

*Siç e kam përmendur te email-et që kemi shkëmbyer, një aplikant nga Tirana statistikisht ka pasur shumë herë më shumë mundësi se një aplikant nga rrethet. Por, siç tregojnë shpërndarja e shumave të parave, duke qenë se në Tiranë shkojnë grantet me vlerë më të madhe, Tirana merr thujse 90% të fondit total.*

*Qartësisht Startup Albania ka dështuar në krijimin e një ekosistemi kombëtar, por jam i sigurt që me milionat e shqiptarëve ka krijuar një ekosistem tيرانas. Një ekosistem që, i fryrë nga lekët e shqiptarëve, arrin të konkurrojë dhe të dëmtojë startupet nga rrethet, me më shumë mundësi financiare për publicitet, makineri më moderne, mundësi për të krijuar rrjete, nëpërmjet eventeve që zhvillohen thujse ekskluzivisht në Tiranë, edhe këto me paratë e të gjithë shqiptarëve.*

*Por Startup Albania nuk ka dështuar vetëm këtu. Startup Albania ka dështuar edhe në përparësitë që qeveria shqiptare i ka caktuar.*

*Startup Albania ka dhënë 22 grante në IT, (te përparësitë S3 nuk duket se ka ndonjë preferencë për IT në krahasim me fushat e tjera), por Startup Albania ka vendosur ndryshe, vetëm 6 në prodhim. Shuma e granteve në IT është sa 12 nënkategori të tjera, ku kategoritë në total, me ndarjen që ka bërë Startup Albania, janë 18. Një preferencë e qartë për IT-në.*

*Dua të kujtoj këtu që është e vështirë të bësh një startup në IT nëse banon në Bulqizë, Konispol, Han i Hotit apo Peshkopi. Ka më shumë gjasa që, nëse je në një nga këto rrethe, të kesh një startup në fusha të tjera. Nëse je në Konispol, ndoshta lidhur me mandarinat; nëse jeton në Bulqizë, me mbetjet e kromit, nëse je në Vlorë me industrinë e turizmit e kështu me radhë.*

*Deri këtu përmenda disa fakte që nuk janë aspak në përputhje me qëllimin e Startup Albania, por situata edhe përkeqësohet.*

*Si përfundim ajo që ka vërtet rëndësi është se përse Tirana merr çdo vit rreth 85%-90% të fondit dhe gjithë qytetet e tjera marrin rreth 10%-15%”.*

*Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Agjencisë Startup Albania, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: “Skemat e startup-eve kanë filluar në mars të vitit 2024 dhe skema e dytë në dhjetor 2025. Në këto dy skema kemi financuar vetëm kompanitë startup dhe jo lehtësuesit.*

*Ne si Agjenci nga pikëpamja politike udhëhiqemi nga Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030 dhe jo nga Strategjia S3.*

*Skema publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë dhe të Ministrisë përgjegjëse dhe publikohet të paktën 30 ditë përpara. Skema aplikohet përmes portalit e-albania dhe ne kërkojmë vetëm tre dokumente të cilat kanë të bëjnë më shumë me aspektin ligjor, që lidhen me pagesën e taksave vendore, energjisë elektrike, etj.*

*Lidhur me objektin e ankesës, informoj se në datë 20.12.2024, kemi vajtur në Vlorë dhe në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë dhe Universitetin e Vlorës, kemi prezantuar skemën, e cila është mbyllur në datë 05.01.2025.*

*Numri i bizneseve të regjistruara në Qarkun Tiranë është shumë herë më i lartë, krahasuar me bizneset e regjistruara në rrethet e tjera dhe si rezultat edhe numri i fituesve do jetë patjetër më i lartë. Të gjithë aplikantët që kanë aplikuar nga Tirana nuk janë detyrimisht nga Qarku Tiranë, por kanë të regjistruar biznesin në Tiranë.*

*Takimet me aplikuesit për prezantimin e skemave, zhvillohen në dy forma, si takime në evente dhe takime online, që kanë dhe numrin më të madh të pjesëmarrësve”.*

*Në vijim të seancës dëgjimore, Agjencia Startup Albania, me shkresën nr. 5/3, datë 22.01.2026, dërgoi informacionin si më poshtë: “Programi për Mbështetjen e Kompanive Startup dhe Lehtësuesve të Startup-eve përmes Granteve dhe Masave Mbështetëse 2025 është hartuar dhe zbatuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 61 datë 7.2.2024 “Për miratimin e kërkesave dhe kritereve që duhet të plotësojnë start-up-et dhe lehtësuesit e start-up-eve, të procedurave dhe të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblimit të anëtarëve të tyre”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren e Thirrjes për Grante 2025 të publikuara në faqen zyrtare të ish Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. (<https://www.sipermarrja.gov.al/akte-ligjore/>)*

Theksojmë se Programi për Mbështetjen e Kompanive Startup dhe Lehtësuesve të Startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse bazohet dhe zbatohet në përputhje të plotë me ligjin dhe vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur, si dhe në zbatim të objektivave dhe orientimeve të përcaktuara në dokumentet e politikave publike, konkretisht në Strategjinë Kombëtare për Sipërmarrjen Inovative. (<https://www.sipermarrja.gov.al/strategjite/>) Në këtë kuadër, Startup Albania, nuk harton apo përcakton politika publike, por ushtron kompetencat e saj ekskluzivisht në funksion të zbatimit të politikave dhe programeve të miratuara nga autoritetet kompetente, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Procedura e thirrjes për grante zhvillohet sipas këtyre fazave:

- Shpallja publike e thirrjes, e cila publikohet në faqen zyrtare të Startup Albania, në rrjetet sociale zyrtare dhe në kanalet e komunikimit të ministrisë përgjegjëse për sipërmarrjen (<https://www.sipermarrja.gov.al/neesroom/thirrja-per-mbeshtetjen-e-kompanive-startup-dhe-lehtesuesit-e-start-up-eve-nepermjet-granteve-dhe-masave-mbeshtetese-2025/>);
- Fushata informuese dhe promovuese, përmes sesioneve informuese, ëorkshop-eve, prezantimeve në qytete të ndryshme të vendit dhe daljeve publike në media;
- Aplikimi elektronik, i hapur për të gjithë subjektet që përmbushin kriteret e përcaktuara në rregullore, pa asnjë kufizim apo diferencim mbi bazë gjeografike;
- Vlerësimi i aplikimeve, i kryer nga një komision i pavarur vlerësimi, i përbërë nga ekspertë të administratës publike, akademisë dhe ekosistemit të inovacionit, mbi bazë kriteresh të paracaktuara, objektive dhe meritokratike;
- Vendimmarrja për financim, e bazuar ekskluzivisht në rezultatin e vlerësimit dhe renditjen përfundimtare të aplikimeve.

Në asnjë fazë të procedurës nuk parashikohet kriter, kufizim apo avantazh i lidhur me qytetin apo zonën gjeografike të aplikantit.

Fondet e programit alokohen në funksion të projekteve fituese dhe vlerës së financimit të miratuar për secilin projekt, në bazë të renditjes konkurruese dhe përmbushjes së kritereve të rregullores.

Për skemat e granteve të implementuara gjatë viteve 2024–2025, përfituesit e këtyre skemave, të ndarë sipas qarqeve, janë si më poshtë:

Tiranë: 146 përfitues

Durrës: 5 përfitues

Fier: 4 përfitues

Elbasan: 4 përfitues

Vlorë: 4 përfitues

Korçë: 3 përfitues

Shkodër: 2 përfitues

Gjirokastër: 2 përfitues

Bazuar në fazën e zhvillimit të startup-eve për vitet 2024-2025 fituesit janë:

Faza fillestare F1 (ide) - 38 fitues shprehur në përqindje 22%

Faza e validimit F2 - 95 fitues shprehur në përqindje 55%

Faza e rritjes F3 - 39 fitues shprehur në përqindje 23%

Për qëllime sqaruese, alokimi financiar paraqitet si më poshtë:

Tiranë 2024: 266,870,550 lekë, Tiranë 2025: 240,670,184 lekë

Qarqet e tjera 2024: 21,400,000 lekë, Qarqet e tjera 2025: 46,394,540 lekë

Ky alokim nuk përfaqëson ndarje paraprake territoriale të fondeve, por është rezultat i drejtpërdrejtë i projekteve të shpallura fituese dhe vlerësimit të tyre në përputhje me parimin e meritokracisë.

Çdo informacion i këtij lloji publikohet dhe përditësohet rregullisht në faqen zyrtare të institucionit: [www.startupalbania.gov.al](http://www.startupalbania.gov.al)

Për më tepër, përveç pamjeve (screenshots) të bashkëlidhura shkresës sonë nr. 5/1, datë 19.1.2026, me qëllim garantimin e transparencës dhe dokumentimit të plotë të aktiviteteve informuese dhe promovuese të Thirrjes për Grante 2025, ju përcjellim edhe lidhjet (link-et) e kanalit zyrtar të Startup Albania në platformën YouTube, ku janë sesionet informuese për publikun dhe aplikantët potencialë”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Subjekti ankues në ankesën objekt shqyrtimi ka pretenduar diskriminim nga ana e Agjencisë Startup Albania, për shkak të vendbanimit.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

*Referuar dokumentacionit kryesor të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se ankuesi pretendon ekzistencën e një skeme faktikisht të pabalancuar territoriale, e cila favorizon aplikantët me vendndodhje në Tiranë, ndërkohë që Agjencia kundërshton këtë pretendim dhe mbron qëndrimin se procedurat janë zhvilluar në mënyrë të hapur, transparente, konkurruese dhe mbi bazë meritokracie.

Nga kalendari i aktiviteteve informuese për Grant 2025 rezulton se, gjatë periudhës 1 dhjetor 2024, deri 5 janar 2025, Agjencia ka zhvilluar një seri aktivitesh informuese dhe konsultuese në formë sesionesh fizike dhe online, me qëllim informimin e publikut të interesuar, studentëve, stafit akademik, sipërmarrësve të rinj dhe aktorëve të ekosistemit të inovacionit. Në dokumentacionin e administruar, një pjesë e konsiderueshme e sesioneve, rezultojnë të jenë zhvilluar në Tiranë, në institucione të arsimit të lartë të vendosura në kryeqytet, dhe një pjesë tjetër e aktiviteteve informuese është realizuar në qytete të tjera të Shqipërisë.

Për sa i përket rezultateve të thirrjeve, nga të dhënat e administruara në dosje rezulton se për vitin 2024 janë regjistruar 538 aplikime, prej të cilave 351 nga Tirana, ndërsa fitues kanë rezultuar 89 aplikantë, prej të cilëve 79 nga Tirana. Për vitin 2025 janë regjistruar 422 aplikime, prej të cilave 270 nga Tirana, ndërsa fitues kanë rezultuar 81 aplikantë, prej të cilëve 67 nga Tirana. Në të njëjtat të dhëna paraqitet se përfitues nga qyteti i Vlorës kanë rezultuar 1 në vitin 2024 dhe 3 në vitin 2025, ndërsa nga Durrësi 2 në vitin 2024 dhe 3 në vitin 2025. Gjithashtu, nga përmbledhja sipas qarqeve për vitet 2024–2025 rezulton se Tirana ka 146 përfitues, ndërsa qarqet e tjera ndjekin me numra më të ulët, 24 përfitues.

Nga të dhënat e paraqitura nga vetë ankuesi, norma e suksesit për aplikantët nga Tirana rezulton 22.51% në vitin 2024 dhe 24.81% në vitin 2025, ndërsa për aplikantët nga qytetet e tjera 5.35% në

vitin 2024 dhe 9.21% në vitin 2025. Këto diferenca, sipas ankuesit, përkthehen në një mundësi disa herë më të lartë për sukses për aplikantët nga Tirana. Edhe pse këto përlllogaritje burojnë nga mënyra e interpretimit të të dhënave nga ankuesi dhe jo nga një raport zyrtar metodologjik i Agjencisë, ato përbëjnë një tregues për analizën nëse skema, përtej neutralitetit të saj sipas kritereve formale, prodhon efekte joproporcionale kur zbatohet në praktikë në të gjithë Shqipërinë.

Gjithashtu, në dokumentacion rezulton se alokimi financiar i fondeve për vitin 2024 ka qenë 266,870,550 lekë për Tiranën dhe 21,400,000 lekë për qarqet e tjera, ndërsa për vitin 2025 240,670,184 lekë për Tiranën dhe 46,394,540 lekë për qarqet e tjera. Agjencia Startup Albania ka argumentuar se ky alokim nuk përfaqëson ndarje paraprake territoriale të fondeve, por rezulton nga cilësia dhe rezultati i projekteve fituese. Ky shpjegim është i rëndësishëm, por nuk e përjashton nevojën për të vlerësuar nëse kushtet reale të konkurrimit kanë qenë në thelb të barabarta për të gjithë aplikantët.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton gjithashtu se ankuesi ka marrë 129.2 pikë nga 350 pikë në total. Agjencia e ka përdorur këtë element për të argumentuar se mosfitimi i ankuesit ka qenë pasojë e rezultatit të vlerësimit dhe jo e vendbanimit të tij. Nga ana tjetër, ankuesi ka ngritur pretendime për mospërputhje ndërmjet sistemit të pikëzimit të përmendur në Rregulloren e Thirrjes, e cila parashikon vlerësim me 70 pikë, dhe referencës së Agjencisë për një total prej 350 pikësh, duke kërkuar qartësim për metodologjinë e vlerësimit. Ky pretendim, pavarësisht se nuk lidhet me shpërndarjen territoriale të fituesve, ka marrë përgjigje nga Agjencia, duke e informuar ankuesin se Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë që vlerësojnë me nga 70 pikë, që në vlerësimin e përgjithshëm bëjnë 350 pikë.

Ligji nr. 25/2022 *“Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”*, i ndryshuar, në nenin 1, ka parashikuar se qëllimi i këtij ligji është hartimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin dhe zhvillimin e startup-eve në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe mbështetjen e ekosistemit vendas të startup-eve.

Në nenin 3/d, përkufizohet se: *“d) “Startup” janë individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese”*.

Neni 4 i këtij ligji përcakton se mbështetja për zhvillimin e startup-eve ka për synim, ndër të tjera, lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimit të veprimtarisë së startup-eve, lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare, si dhe përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike. Këto objektiva dëshmojnë se ligjvënësi nuk ka synuar vetëm ngritjen e një skeme formale financimi, por një zhvillim gjithëpërfshirës të ekosistemit kombëtar të startup-eve.

Në nenin 14/3 të ligjit përcaktohet se: “Thirrja për aplikime për përfitimin e granteve dhe të masave mbështetëse përmban kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, procedurat dhe afatet respektive, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh prioritetet e përgjithshme si më poshtë:

a) mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;

b) mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;

c) fuqizimi i të rinjve;

ç) fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse;

d) fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;

dh) prioritete të tjera, sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen”.

Me VKM nr. 467, datë 26.7.2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve”, është përcaktuar se Startup Albania ka si mision të sigurojë mirëfunksionimin e ekosistemit të startup-eve në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet mbështetjes dhe zhvillimit të tij, si dhe se e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë akt parashikohet gjithashtu se Startup Albania menaxhon dhe monitoron realizimin e masave mbështetëse financiare, organizon punën për promovimin e nismave në ekosistemin e startup-eve dhe ushtron funksione mbështetëse për startup-et dhe lehtësuesit. Ky kuadër normativ i jep Agjencisë një mandat kombëtar dhe jo të kufizuar në territor.

VKM nr. 61, datë 07.02.2024, “Për miratimin e kërkesave e të kriterëve që duhet të plotësojnë Startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kriterëve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblyerimit të anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, përcakton kërkesat, kriteret, procedurat dhe afatet për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse, si dhe rregullat për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit. Në këtë akt parashikohet se Startup Albania harton dhe publikon në faqen e saj thirrjen publike, fondin në dispozicion, dokumentacionin përkatës, udhëzimet e detajuara, kriteret minimale, kushtet e grantit, mënyrën e vlerësimit, si dhe listën e projekteve dhe vlerësimet përfundimtare. Subjektet përfituese duhet të jenë të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik dhe të pajisura me pasaportën përkatëse, ndërsa përzgjedhja kryhet sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në këtë kuadër. As në këtë akt nuk parashikohet një kriter i drejtpërdrejtë territorial për përjashtim ose penalizim të aplikantëve.

Në Kreun III, pika 3 e kësaj VKM-je, përcaktohet se, afati dhe periudha e thirrjes nuk mund të jetë më pak se 10 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 ditë.

Rregullorja e Thirrjes Grant 2025 përcakton se programi synon të stimulojë sipërmarrjen inovative duke financuar kompanitë startup më premtuese shqiptare, mbi bazë konkurruese, në funksion të

cilësisë së aplikimeve dhe të fondit në dispozicion. Po aty parashikohen kategoritë e përfituesve, dokumentacioni i kërkuar, procedurat e aplikimit, kriteret e vlerësimit dhe përgjegjësitë e fituesve.

Rregullorja thekson se procedurat duhet të jenë transparente, të drejta dhe të orientuara drejt evidentimit dhe mbështetjes së sipërmarrësve më të talentuar.

Nga shqyrtimi i këtyre akteve rezulton se kriteret e aplikimit dhe të vlerësimit janë të formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk përmbajnë si kriter përjashtues apo penalizues vendbanimin ose vendndodhjen territoriale të aplikantit.

Së fundi, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024–2030 njih shprehimisht ekzistencën e pabarazisë rajonale dhe rurale (faqe 41) si pjesë e diagnozës së ekosistemit dhe parashikon masa për mundësimin e rritjes përmes infrastrukturës së hapur të inovacionit, përfshirë qendrat rajonale të transformimit, platforma dixhitale dhe entitete të tjera të ekosistemit. Kjo strategji përbën një tregues të rëndësishëm të vullnetit shtetëror për të adresuar jo vetëm zhvillimin e përgjithshëm të startup-eve, por edhe balancimin territorial të ekosistemit.

Komisioneri vlerëson se objekti i ankesës nuk është kontrolli i përgjithshëm i mundësive të politikës shtetërore të mbështetjes së startup-eve, as vlerësimi i projektit të ankuesit nga ana e Komisionit teknik, por verifikimi nëse, në rastin konkret, kriteret, praktikat ose mënyra e zbatimit të skemës së financimit nga Startup Albania kanë prodhuar një trajtim të padrejtë dhe jo të barabartë ndaj ankuesit, për shkak të vendbanimit.

Nga analiza e akteve ligjore të sipërcituara dhe konkretisht ligji nr. 25/2022, VKM nr. 61/2024, VKM nr. 467/2023 dhe Rregullores së Thirrjes Grant 2025, nuk rezulton që vendbanimi apo vendndodhja gjeografike e aplikantit të jetë parashikuar si kriter përjashtues, kufizues apo penalizues në procesin e aplikimit, kualifikimit ose vlerësimit. Përkundrazi, kuadri normativ është ndërtuar mbi kritere që, të paktën në formë, paraqiten neutrale dhe të lidhura me përmbushjen e kushteve formale dhe me cilësinë e projektit.

Startup Albania ka informuar se kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë zbatuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë aplikantët dhe se rezultatet e ndryshme sipas qarqeve lidhen me numrin e aplikimeve dhe me cilësinë e projekteve konkurruese. Lidhur me këtë arsyetim, Komisioneri vlerëson se, megjithëse shpërndarja territoriale e aksesit në informacion dhe në ekosistemin mbështetës meriton vlerësim dhe përmirësim të mëtejshëm nga ana e institucionit, nga provat e administruara nuk rezulton që subjekti ankues të jetë vendosur në mënyrë individuale në një situatë më pak të favorshme, në raport me persona të tjerë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, për shkak të vendbanimit të tij.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se Agjencia Startup Albania, nuk harton apo përcakton politika publike, por ushtron kompetencat dhe funksionet e saj në zbatim të legjislacionit në fuqi, sipas kriterëve të miratuara.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se situata përjashtuese në të cilën është vendosur ankuesi si pasojë e skualifikimit, pasi nuk kishte marrë pikët e duhura, është në mënyrë objektive e justifikuar, pasi lidhet me kërkesat e ligjit dhe të Komisionit të Vlerësimit, për të siguruar cilësinë e projekteve dhe jo shpërndarjen territoriale të fituesve.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pabarabartë nga ana e Startup Albania, krahasuar me aplikantët e tjerë, pasi nga dokumentacioni i administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk provohet se vendbanimi i tij ka shërbyer si bazë për trajtim të ndryshëm, përjashtim apo kufizim në procedurën e aplikimit dhe vlerësimit. Për rrjedhojë, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Agjencisë Startup Albania.

- Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim të tërthortë.

Ligji 10221/2010, i ndryshuar në nenin 3/7, përcakton se: *““Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme, për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”*.

Në analizë të pretendimit të subjektit ankues për diskriminim të tërthortë, Komisioneri vlerëson se në rastin konkret nuk jemi përpara një kriteri të shprehur normativ që përjashton aplikantët me vendbanim jashtë Tiranës. Nga shqyrtimi i ligjit nr. 25/2022 *“Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”*, të ndryshuar, të VKM nr. 61, datë 7.2.2024, të ndryshuar, si dhe të Rregullores së Thirrjes Grant 2025, rezulton se kriteret e aplikimit dhe të vlerësimit janë formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk parashikojnë si kusht apo kriter përzgjedhës vendbanimin, qarkun apo vendndodhjen territoriale të aplikantit. Në këtë kuptim, dispozitat dhe kriteret e zbatueshme paraqiten neutrale.

Në çështjen objekt shqyrtimi, nga vlerësimi i dokumenteve, vërehet se ekziston një përqendrim i dukshëm i aktiviteteve informuese të zhvilluara në Tiranë, një përqendrim i lartë i aplikimeve dhe fituesve në Tiranë, si dhe një shpërndarje e fondeve që anon drejt kryeqytetit. Këto të dhëna, të marra së bashku, janë të mjaftueshme për të ngritur një dyshim objektiv se akses real në skemën publike të financimit mund të mos ketë qenë thelbësisht i njëjtë për sipërmarrësit e të gjitha qarqeve. Në veçanti, kur një autoritet publik me mandat kombëtar organizon informimin dhe ndërveprimin me publikun kryesisht aty ku ekosistemi është më i përqendruar, ekziston rreziku që kriteri formalisht neutral i “cilësisë së projektit” të ndërthuret me pabarazi paraprake në akses ndaj informacionit, rrjeteve dhe asistencës.

Megjithatë, për ekzistencën ose jo të diskriminimit të tërthortë, duhet të shqyrtojë nëse zbatimi konkret i kësaj skeme publike ka prodhuar pasoja dukshëm më pak të favorshme për një kategori personash të mbrojtur nga ligji, në rastin konkret për aplikantët me vendbanim jashtë Tiranës. Pikërisht për këtë arsye, Komisioneri i është referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje, të paraqitura nga vetë Agjencia dhe nga subjekti ankues.

Nga këto të dhëna rezulton se për vitin 2024 janë regjistruar gjithsej 538 aplikime, prej të cilave 351 nga Tirana dhe 187 nga qytetet e tjera. Po për këtë vit, kanë rezultuar 89 fitues, prej të cilëve 79 nga Tirana dhe 10 nga qytetet e tjera. Për vitin 2025 janë regjistruar 422 aplikime, prej të cilave 270 nga Tirana dhe 152 nga qytetet e tjera, ndërkohë që fitues kanë rezultuar 81 aplikantë, prej të cilëve 67 nga Tirana dhe 14 nga qytetet e tjera.

Nga i njëjti dokumentacion rezulton gjithashtu se fondi i alokuar për vitin 2024 ka qenë 266,870,550 lekë për Tiranën dhe 21,400,000 lekë për qytetet e tjera, ndërsa për vitin 2025 fondi i alokuar ka qenë 240,670,184 lekë për Tiranën dhe 46,394,540 lekë për qytetet e tjera.

Nga krahasimi i këtyre statistikave rezulton se, ndonëse në vitin 2024 aplikimet nga Tirana përbëjnë rreth 65.2% të totalit, fituesit nga Tirana përbëjnë rreth 88.8% të totalit të fituesve dhe përfitojnë rreth 92.6% të fondit të shpërndarë. Ndërsa aplikimet nga qytetet e tjera përbëjnë rreth 34.8% të totalit, fituesit nga këto qytete përbëjnë vetëm rreth 11.2% të totalit të fituesve dhe përfitojnë rreth 7.4% të fondit. Po kështu, për vitin 2025, aplikimet nga Tirana përbëjnë rreth 64% të totalit, ndërsa fituesit nga Tirana përbëjnë rreth 82.7% të totalit të fituesve dhe përfitojnë rreth 83.9% të fondit. Në të kundërt, aplikimet nga qytetet e tjera përbëjnë rreth 36% të totalit, ndërsa fituesit prej tyre përbëjnë vetëm rreth 17.3% të totalit të fituesve dhe përfitojnë rreth 16.1% të fondit.

Po nga përpunimi i të dhënave, të paraqitura nga subjekti ankues, rezulton se norma e suksesit për aplikantët nga Tirana në vitin 2024 ka qenë 22.51%, ndërsa për aplikantët nga qytetet e tjera vetëm 5.35%. Në vitin 2025, norma e suksesit për aplikantët nga Tirana ka qenë 24.81%, ndërsa për aplikantët nga qytetet e tjera 9.21%. Këto shifra tregojnë se aplikantët nga Tirana kanë pasur më shumë mundësi për të rezultuar fitues në krahasim me aplikantët nga qytetet e tjera dhe se kjo diferencë nuk shfaqet si rast i izoluar, por si një model i përsëritur në dy vite radhazi, pavarësisht se në vitin 2025, numri i përfituesve nga rrethet ka qenë më i lartë.

Duke analizuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se të dhënat statistikore të administruara, provojnë ekzistencën e një efekti joproportional negativ për aplikantët me vendbanim jashtë Tiranës. Pra, ndonëse skema e financimit nuk bën dallim formal në bazë të vendbanimit, rezultatet e saj tregojnë se aplikantët jashtë Tiranës janë vendosur në kushte dukshëm më pak të favorshme si në raport me mundësinë për t'u shpallur fitues, ashtu edhe në raport me vlerën e financimit të përfituar.

Lidhur me justifikimin objektiv të kësaj situatë, Startup Albania ka pretenduar se kriteret janë bazuar në meritë, cilësi projekti, vlerësim konkurrues dhe se Tirana ka numrin më të madh të bizneseve të regjistruar, si dhe vendbanimi nuk ka qenë kriter përzgjedhës.

Komisioneri vlerëson se synimi për të përzgjedhur projektet më të mira dhe për të administruar fondet publike mbi bazën e meritës është në vetvete një synim i ligjshëm. Po ashtu, përdorimi i komisionit të vlerësimit dhe i kriterëve të cilësisë së projektit përbën në parim një mjet të përshtatshëm për arritjen e këtij synimi.

Gjithashtu, bazuar në kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i sipërcituar, Agjencia Startup Albania, nuk është në pozitat e vendosjes së kriterëve preferencialë, sipas vendndodhjes së bizneseve, pasi këtë kompetencë e ka Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet miratimit të ligjit 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, të ndryshuar.

Megjithatë, Agjencia Startup Albania, bazuar në gjetjet e vendimit të Komisionerit, si dhe bazuar në kompetencën e saj, sipas Kreut VIII, pika 2, të VKM 61, datë 07.02.2024, në të cilën parashikohet: “Startup Albania kryen monitorimin e zbatimit të projekteve dhe raporton për mbarëvajtjen e tyre pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen”, duhet të kryejë një studim më të thelluar, për këtë çështje dhe ti përcjellë rezultatet, ministrit përgjegjës, për të propozuar ndryshimet e duhura.

Në çështjen objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se Startup Albania, në konceptimin dhe zbatimin e thirrjeve të ardhshme, duhet të reflektojë në mënyrë më të qartë dhe më të dokumentuar detyrimin për akses të barabartë territorial. Kjo kërkon jo domosdoshmërisht cenimin e parimit të konkurrimit apo të meritës, por forcimin e kushteve të barazisë reale në fazën e informimit, asistencës dhe përgatitjes së aplikimeve, si dhe monitorimin më transparent të rezultateve sipas qarqeve. Ky detyrim buron nga vetë fryma e ligjit për startup-et dhe nga Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024–2030, e cila njih shprehimisht hendekun rajonal dhe e trajton atë si çështje të politikës publike që duhet adresuar.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. E.Ç nga ana e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve.
2. Rekomandohet që Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve në kuadër të thirrjeve të ardhshme për grante, të marrë masa për garantimin e aksesit real dhe të barabartë territorial, duke përfshirë:
  - sigurimin e një shpërndarjeje më të balancuar territoriale të aktiviteteve të prezantimit;
  - vlerësimin institucional të masave të mundshme korigjuese, në përputhje me ligjin dhe kuadrin sektorial, për adresimin e pabarazive rajonale në ekosistemin e startup-eve.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**